




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Z. Skender KRASNIQI
Pronar
NEWS TV
“News TV” Sh.p.k
Nr. i biznesit 70636719
Rr / Rexhep Luci nr.13
Prishtinë

Znj. Selvete BYTYQI
Personi fizik i propozuar
“News TV” Sh.p.k.
Nr. i biznesit 70636719
Rr / Rexhep Luci nr.13
Prishtinë

Ref: 1409/1067/LIC/ni

VENDIM

*lidhur me ndryshimin e personit fizik të pronësisë së Ofruesit të Shërbimeve Programore
NEWS TV - Prishtinë*

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. News TV është Ofrues i Shërbimeve Programore (OSHP), i cili është i licencuar për të transmetuar TV programe përmes rrjetit të Operatorve Kabllorë, me seli në Prishtinë. News TV është pajisur nga KPM, me licencë të transmetimit, me datën 18 shkurt 2009.
3. Me datën 11 shtator 2014, pronari i OSHP News TV ka dorëzuar në zyrën e KPM-së kërkesën për ndryshimin e personit fizik të pronësisë së OSHP News TV, duke kërkuar që personi fizik aktual i OSHP News TV z. Skender Krasniqi të zëvendësohet me znj. Servete Bytyqi, si pronare e re e personit juridik “News TV” Sh.p.k. me nr. të biznesit 70636719.
4. Ndryshimi i personit fizik nuk përbënë edhe ndryshimin e personit juridik përfshirë edhe emrin, numrin e biznesit si dhe të dhënat tjera relevante që janë pjesë përbërëse e personit juridik në fjalë, në emër të së cilit është lëshuar licenca e KPM-së për OSHP News TV.
5. Kërkesa për ndryshimin e personit fizik të OSHP News TV mbështetet në nevojën e domosdoshme, me qëllim të respektimit të Ligjit të KPM-së si dhe akteve nënligjore, pasi që

1/2

personi fizik aktual z. Skender Krasniqi është angazhuar si person publik në institucionet publike të Republikës së Kosovës.

6. Përmes një deklaratë individuale, si pjesë e kërkesë znj. Servete Bytyqi, kandidatë për pronare të News TV, ka theksuar se, përveq ndryshimit të personit fizik, nuk do të ketë ndryshime në mbarëvajtjen e punës së OSHP News TV, përfshirë edhe formatin e programit sipas licencës së KPM-së.

Arsyetimi


7. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
8. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
9. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
10. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
11. Komisioni kontaton se, ndryshimi i personit fizik të OSHP News TV është në pajtim të plotë me nenin 15.4 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
12. Arsyetimin për ndryshimin e personit fizik të OSHP News TV nga ana e parashtruesit të kërkesës, Komisioni e konsideron të mjaftueshëm dhe në pajtim me procedurat e KPM-së, dhe në shërbim të interesit publik, duke marrë parasysh se nuk do të ketë ndryshime në skemën programore dhe në strukturën organizativ të News TV.

Vendim

13. Komisioni merr vendim për ndryshimin e personit fizik të OSHP News TV, sipas kërkesës së parashtruar nga pala parashtruese.


Lëshimi i Vendimit

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.


Adnan MEROVCI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



01.10.2014

datë